



Ndërtesa e Elektrokosovës
Bulevardi Bill Klinton nr.3
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

*Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.3
Prishtina 10 000
Republic of Kosovo*



Përgjigjet në Lidhje me Raportin Konsultativ të ZRRE,së për Jetëgjatësinë e Aseteve

Prishtinë 18.07.2017



Me datë 04.07.2017 KEDS ka pranuar Raportin Konsultativ në Lidhje me Jetëgjatësinë e Aseteve. Në parim KEDS pajtohet me propozimin e ZRRE'së përveçse disa ndryshime të vogla që kanë lindur me inovacionet teknologjike të shpeshta që po ndodhin kohëve të fundit edhe në sektorin e energjisë. Në tabelën e mëposhtme janë përshkruar propozimi i KEDS, it për kategoritë e asetëve dhe jetëgjatësinë e tyre përkatëse.

Propozimi i KEDS për Periudhën e Dytë Rregullative 2018-20022		Jetëgjatësia e asetëve (vjet)
Kategoritë e Aseteve		
I	Ndërtesat e administratës	50
II	Rrjetet e TM, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	30
III	Rrjetet TU, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	20
IV	Stacionet e transformatorit, transformatorët e shpërndarjes, dhe pajisjet	15
V	Kamionët, korpa dhe makineri për punë	10
VI	Njehsorët dhe pajisjet matëse,	8
VII	Mobilet, pajisjet për zyrë	5
VIII	Pajisjet e punës, aparatet e pajisjet lexuese, veturat, Kompjuterët	5
IX	Pajisjet TI dhe softuerë	3

Në lidhje me kategorinë e parë dhe të dytë KEDS nuk ka ndonjë koment specifik dhe pajtohet me propozimin e ZRRE'së si për kategorinë e asetëve ashtu edhe për jetëgjatësinë e tyre përkatëse.

Megjithatë, në raportin konsultativ të ZRRE'së rrjeti i TM dhe TU dhe pajisjet e tyre përkatëse janë paraqitur në një kategori të vetme me jetëgjatësi tridhjetë vjeçare. KEDS propozon një kategori tjetër për rrjetin TU dhe pajisjet e tij përkatëse. Rrjeti i TU duke pasur në konsideratë gjendjen aktuale të tij, në parim amortizohet më shpejt se rrjeti i TM. Kështu që KEDS propozon që për TU dhe pajisjet e tij përkatëse që jetëgjatësia të përcaktohet për njëzet vjet.

Në lidhje me kategorinë e katërt të asetëve KEDS pajtohet me propozimin e ZRRE'së.

Në lidhje me kategorinë e pestë të asetëve KEDS pajtohet me propozimin e ZRRE'së për jetëgjatësinë dhjetë vjeçare të kamionëve dhe makinerive të rënda për punë . KEDS propozon që të shtohet një kategori e re për njehsorët dhe pajisjet matëse, respektivisht kategoria e gjashtë e asetëve. Jetëgjatësia e njehsorëve dhe pajisjeve matëse duhet të jetë në harmoni me kërkesat ligjore. Kalibrimi i njehsorëve dhe pajisjeve matëse është e detyrueshme të bëhet çdo 8 vjet. Me ndryshimin e inovacionit dhe teknologjisë në sistemet matëse është më pragmatike dhe efikase nga ana e reduktimit të kostove dhe përmirësimit të saktësisë së matjes.



Ndërtesa e Elektrokosovës
Bulevardi Bill Klinton nr.3
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

Elektrokosova Building
Bill Clinton Boulevard no.3
Prishtina 10 000
Republic of Kosovo



Jetëgjatësia për kategorinë e shtatë është propozuar nga ZRRE'ja që të jetë shtatë vjet. KEDS mendon se jetëgjatësia e propozuar nga ZRRE'ja është paksa e lartë për mobilet dhe pajisjet për zyrë. KEDS propozon që jetëgjatësia e kategorisë së aseteve në fjalë të përcaktohet pesë vjet.

Në Lidhje me kategorinë e tetë të aseteve dhe jetëgjatësisë së tyre, KEDS pajtohet me propozimin e ZRRE'së për pajisjet e punës, aparatet e pajisjet lexuese, veturat dhe kompjuterët. Në lidhje me Pajisjet TI dhe softuerë KEDS propozon që jetëgjatësia për to të përcaktohet tre vjet. Periudha pesë vjeçare për pajisjet TI dhe softuerë është e gjatë dhe këto pajisje nuk do të kenë vlerë ekonomike dhe teknike për t'ju përgjigjur kërkesave bashkëkohore të sistemeve elektroenergjetike.

KEDS propozon që kategoritë e reja të miratuara nga ZRRE'ja të aplikohen edhe në asetet ekzistuese ashtu si edhe në asetet e reja. KEDS është i vetëdijshëm se ri kategorizimi i aseteve ekzistuese është një sfidë e madhe por me burimet njerëzore dhe informatike që ka është në gjendje ta kalojë këtë sfidë në afatet kohore që do të kërkohen. Kjo qasje gjithashtu krijon mundësinë e rishikimit dhe krahasimit të jetëgjatësisë duke mundësuar elasticitet dhe transparencë të bazës së rregulluar të aseteve.

KEDS shpreson që ZRRE,ja të marrë parasysh propozimet e KEDS'it të paraqitura më lart.